

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **641-25-8093-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“N&B” SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llaush,pn

(Adresa)

Skenderaj

41000

(Vendi)

043/999990

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

Niman Babaj

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nbconstruction018@gmail.co

(Adresa elektronike)

30.10.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

AK: KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ

- **-B05 Njoftim për Kontrat me date: 14.09.2025**
- **B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 24.09.2025**
Dosja e Tenderit me date: 26.09.2025
- **Përshkrimi i cmimëve Stad..xlsx me date: 22.09.2025**
- **B12-PROCESVERBALI I HAPJES me datë: 01.10.2025**
- **B58-NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK-se. me datë: 10.10.2025**
- **Kërkesa për Ri-shqyrtim dorezuar në AK me dt 14.10.2025**
- **Vendimi për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim 20.10.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 27 Dosja e Tenderit
- NENIN e 38-të të LPP-së -Kontratat Publike Kornizë
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

- Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
- Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë: 10.10.2025 AK: KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ

ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Ak, pas vlerimit të ofertave, duke e marrë parasysh që kei qene e vetmja Oferte e ofruar ne kete procedur, AK ka shpallur vendim per anulimin e procedures, pa ofruar nje deshmi konkrete pse, por vetem gjeja qe ne paramas nuk jan inkormoruae disa pozicione sipas tyre jan te domosdoshme per realizimin e projektit

(Arsyetimi i Anulimit te Ofertes)

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ³

Dt: 09.10.2025 Komuna e Leposaviqit

AK: Kuvendi Komunal i Leposaviqit Rr. 24 nentori 4350 Leposaviq

OE. Grup i Operatorëve Ekonomik N & B SH.P.K.; PROGEO CONSULTING SH.P.K.; Berisha Company SH.A.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.; ARCHING GROUP SH.P.K, LLAUSHE, 41000, SKENDERAJ.

Nr. i prokurimit:	641-25-8093-5-1-1
-------------------	-------------------

Titulli: NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA I

I nderuar Z. *Niman Babaj*

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]* Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Gjatë hartimit dhe perplimit të përshkrimit të çmimeve nga njësia jonë e kërkesës kanë rrjedhur disa gabime ku si rrjedhojë kanë mbetur disa pozicione pa u inkorporuar në përshkrimin e çmimeve dhe disa permirsime në sasi e paramases të cilat pozicione janë të domosdoshme për mbarvajtjen e projektit dhe kryerjen me sukses të projektit në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit
Komuna e Leposaviqit
Bajram Jashari

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Pra Ak ka anluar proceduren me pretendimet gjeja qe nuk jan inkorporuar disa pozicione, te cilen e konsiderojm te pa qendrueshem sepse eshte Kontrat Korniz, dhe mund te polesohen me MINI-Tender gjate procedurave nese është ashtu siq pretendojn. Por ne Kekresen per Ryshqyrtim ne kemi kerkuar qe te na deshmoj me nje Kekres nga Studio Projektuese apo Kopmani Projektuese, sepse nuk mundet Ak te ndryshoj diqka ne Projekt pa aprovimin e Kompanis Projektuese.

Ne vazhdim Ak ne refuzimin e Kekreses per Ryshqyrtim ka manipuluar me data nje Kekres nga Drejtoria e Urbanizmit gjeja qe ata kan kerkuar per ndryshim, por nuk kan ofruar nje email zyrtart qe eshte bere me date para hapjes se Ofertes, gjë ne te cilen ne nuk dyshojm po jemi te sigurt qe është manipulim i llojit kriminal nga Ana e Akse apo disa personave zyrtar qe jan pjese e Komisionit Vlersues, pasi qe Oferta jone nuk ka qene Oferta te cilen ata e kan pritur apo nuk ka qene GOE e favorizuar e tyre (“ Me pazare nen Tavolina”).

Do e paraqesim edhe vednimin per refuzim te kerkeses per Ryshqyrtim, e cila en per tu analizuar dhe verifikuar pasi nuk e konsiderojm valide:



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E LEPOSAVIQIT OPŠTINA LEPOSAVIĆ - MITROVICA OF LEPOSAVIC	
Nr. Prokurimit / Organizatës, publike / Org. publike Str.	1
Nr. Prokurimit / Prokurimit	2851
Nr. Kërkësës / Kërkesës dhe pagesë	2-Dsh. / Data / Datë: 20.10.2025

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Leposaviqit / Opština Leposavić / Municipality of Leposavic

Drejtoria për Prokurim Publik

Nr. 2851/25

Dt. 20.10.2025

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të **N&B Shpk me seli në Skenderaj**, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues, për Vendimin e AK, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të OE në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, **me datën 17.10.2025** mori këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet Kërkesa për rishqyrtim e subjektit të N&B Shpk me seli në Skenderaj, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër **vendimit për anulim** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1, me nr. të prokurimit: Nr. Prok: 641-25-8093-5-1-1** Autoritetit Kontraktues, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63.1.3. të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, do të vazhdoj me rivlerësim të aktivitetit të prokurimit.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Me vendimin e Autoritetit Kontraktues ka marrë vendim që në aktivitetin e prokurimit: **"NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1, me nr. të prokurimit: Nr. Prok: 641-25-8093-5-1-1, të anuloj aktivitetin," NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NË LEPOSAVIQ – FAZA 1, me nr. të prokurimit: Nr. Prok: 641-25-8093-5-1-1.**

Në Kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga **N&B Shpk me seli në Skenderaj**, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht nenet: 1, 7, 59, 62 dhe 72, të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga **N&B Shpk me seli në Skenderaj**, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht nenet: 1, 7, 59, 62 dhe 72, të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Ankuesit të paraqitura përmes Kërkesës për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se kërkesa për rishqyrtim e ankuesit është pjesërisht e bazuar. Mirpo AK i qëndron vendimit të mëhershëm për Anulimin e saj duke u bazuar në kërkesën e Njësisë Kërkuese që duhet bërë ndryshime bazike në disa përcilje të paramasës.

Në bazë të fakteve të cekura më lartë, dhe në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me dhe nenin 63.1.3, të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin

E nderuara OSHP, i nderuar Ekspert Shqyrtues, ne kerkkojm qe gjate ekzaminimit te marrni edhe dokumtacionin me email te Drejtoris se Prokurimit, pasi qe nuk kan emile me date apo stemp date, apo dhe nje deshmi se kan opranuar email para dates se kerkeses per rishqyrtim nga ana e jone, letra e cila eshte ngarkuar gjeja qe nga drejtoria eshte e manipuluar dhe per kete arsye eshte deshmuar vetem ne PDF.

Dokumenti i Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit nuk ka datë të verifikuar (timestamp), email-header dhe as provë të origjinës. Apo dhe nje kerkes nga Projektuesi.

Sipas Neni 38 i LPP-së:

- Aktiviteti është kontratë kornizë → plotësimet mund të bëhen gjatë ekzekutimit
- lejohen mini-tendera
- punët shtesë mund të shtohen më vonë

Pra justifikimi i AK-së është jo-relevant.

Dhe sipas gjithë kesaj anulimi bie ndesh me Nenit 62 të LPP-së

Neni 62 lejon anulim vetëm në raste të jashtëzakonshme:

- shkelje të rëndë ligjore që nuk mund të rregullohen me korrigjim
- çmime mbi buxhet
- ngjarje objektive

Asnjë nga këto nuk ekziston në këtë rast.

Pra konsiderojm që Anulimi është i paarsyeshëm dhe jo-proporcional AK ka justifikuar anulimin me “pozicione dhe sasi të painkorporuara në paramasa”. Duke e marr parasush që është një KONTRAT KORNIZ dhe është vetëm FAZA-1 e punimeve këto pozicione nëse eegsistojn mund të dalin në FAZEN e-2 po të shpallen me mini Tender sipas Rregullores dhe Ligjeve të Prokurimit Publik.

Ne e konsiderojm veten të diskriminuar tej mase dhe të prejashtur, pasi që nuk kemi qene GOE e favorizuar andaj kerkojm që Ak të rreprektoj NENIN 7 të LPP-se ku të gjithë Operatorët Ekonomik duhet të trajtohen njëte dhe pa diskriminuar, sepse edhe ne jemi Tatim pagues të Republikës së Kosovës, dhe jemi OE të këtij vendi dhe meritojm të Trajtohemi njëjt.

Duke bërë Arsyrtim që janë Harrur disa pozicione të inkorporohen në Paramas, dhe sasi të cilat gjeja janë të domosdoshme për mbarvajtjen e projektit.

Me këto duam të theksojm që Ak ka bërë shkelje ligjore dhe nuk ka respektuar Ligjet e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, duke bërë anulim të procedurës pa një arsye konkrete as të bazur. Theksojm që me këtë vendim Ak ka shkelur NENIN 7-të të LPP-se duke na diskriminuar me anulim të procedurës në mënyrë të njëanshme dhe pa arsye, pasi që projekti në fjalë është Kontrat Kornizë dhe është Vetëm Faza e Parë e projektit aludiment për pozicione të pa inkorporuara nuk qendrojnë pasi që ato nuk kanë të bëjnë me mbarvajtjen e Procedurës dhe si të tilla mund të propozohen edhe gjatë ekzekutimit të punimeve pasi është Faza parë dhe është Kontrat Korniz.

Duke u bazuar në njoftimin tuaj për anulimin e aktivitetit të prokurimit të lartcekur, ne si GOE konsiderojmë se vendimi për anulim duhet të rishqyrtohet, për këto arsye:

1. Gabimet e përmendura në përkrahimin e çmimeve dhe pozitive janë të natyrës teknike dhe mund të korrigojnë lehtësisht përmes sqarimeve apo korrigjimeve të dokumenteve të tenderit, pa qenë e nevojshme anulimi i plotë i procedurës, në përputhje me Nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Anulimi i aktivitetit dëmton konkurrencën dhe vonon zbatimin e projektit publik, gjë që bie ndesh me parimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit të prokurimit, të përcaktuar në Nenin 7 të LPP-së.
3. Vendimi për anulim nuk është proporcional me natyrën e gabimit dhe mund të korrigojë përmes njoftimeve shtesë apo ndryshimeve të dokumentacionit të tenderit, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik (neni 18 – “Korrigjimet dhe sqarimet gjatë procesit të prokurimit”).

Por Ak ka qarur në Anulim duke mos Ofruar as një sqarim se cilat qenkan pozicionet që duhet të inkorporohen, apo dhe një shkres me shkrim para datës së Anulimit që Kompania Projektuese duhet ta konfirmoj që ka gabim apo duhet të shtohet a të hiqet diçka nga paralogjaria, Ne kerkojm që Ak të na dokumentoj me një email apo diçka zyrtare që Kompania Projektuese ka kërkuar që të inkorporohen Pozicione tjera apo dhe ndryshime të

Projektit, Madje kerkojm edhe qasje ne Procedurat e Vlerismit te Komisionit Vlerues.

Ne kete Rast Ak ka marr vete kompetencat e Projektuesit duke anulur nje anshem, dhe na ka ofruar "GJEJA nje Kerkes nga Drejtoria per Kultur Rini dhe Sport" e cila dyshojm dhe jemi te binur qe nuk qendron.. dhe kerkojm nga OSHP qe ta hetoj edhe kete pjes, gje e cila na lejon te aludojm qe eshte bere vetem per interesa te personave te Caktuar apo per mos pjesmarrje ne Aktivitetet te kompanive te favorizuara nga ana e tyre. E cila eshte ne kundershtrim me Nenin 7 te LPP-se dhe Nenin 1 te Lpp-se.

Duke u bazur ne Nenin 62 te Lpp-se

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Qe do te thot asnjera nga keto arsye nuk ka qendruar ne proceduren e Tenderimit, por haptasi ka te beje me Favorizime dhe mos pjesmarrje te Kompanive Favorizuese nga Ana e Ak-se ne kete procedur.

*Ak ne arsyetimin e dhene per anulimin e Procedures është e pa bazze dhe ne kundershtrim me NENIN e 38-të të LPP-së -**Kontratat Publike Kornizë** i cili e specifikon qe ne kontrat korniz Ak mund te shpall MINI-Tender per plotesimin e Punëve shtesë e cila është e njejta me Proceduren qe ne kemi tenderuar.*

Neni 38

Kontratat Publike Kornizë

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, të kufizuar apo të negociuar për të dhënë një kontratë publike kornizë. Kontrata publike kornizë nuk do të mund të jepet duke përdorur çfarëdo procedure tjetër.

2. Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen. Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se

plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

3. Autoriteti kontraktues mund shpërblejë një kontratë publike kornizë kur ka në plan të shpërblejë disa kontrata identike gjatë periudhës që do të përfshihet nga kontrata publike kornizë, dhe konkluzioni i një kontrate publike kornizë që mbulon kontrata të tilla do të reduktonë shpenzimet e prokurimit dhe administrimit të autoriteteve kontraktuese përkatëse.
4. Pas dhënies së kontratës në bazë të paragrafit 1. të këtij neni kontrata publike kornizë lejon autoritetin kontraktues që gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj të bëjë porosi ose të lidh nën-kontrata në bazë të mini-tenderëve.
5. Kontratat publike kornizë mund ti shpërblehen:
 - 1.1. një operatori ekonomik dhe në këtë rast duhet të përfshihen të gjitha kushtet e nevojshme për të lejuar që porositë të bëhen vetëm në bazë të kontratës, ose
 - 1.2. më shumë se një operatori ekonomik, por të paktën tre, dhe në këtë rast duhet të përfshijnë kriteret e dhënies që do të përdoren për mini-tenderë. Kontratat e tilla kornizë mund të lënë në mënyrë të qartë disa kushte të veçanta të cilat do të përcaktohen në kontratat ndihmese.
2. Vetëm operatorët ekonomik që janë palë të kontratës publike kornizë mund të marrin pjesë në mini-tenderë, sipas nën-paragrafit 5.2 paragrafi 5 të këtij neni. Në rast të përdorimit të mini-tenderëve autoriteti kontraktues i fton të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë palë të kontratës publike kornizë që të paraqesin ofertat e tyre me shkrim. Afati për dorëzimin e ofertave duhet të jetë së paku pesë (5) ditë. Autoritetet kontraktuese duhet të shpërblejnë kontratën tek operatori ekonomik që ka dorëzuar ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies të përcaktuara në ftesën për ofertim. Në rast se jo të gjithë Operatorët Ekonomikë që janë palë të Kontratës Publike kornizë dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme. Autoritetet Kontraktuese do të shpërblejnë kontratën operatorit ekonomik që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterit të dhënies të përcaktuar në ftesën për ofertim. Secili shpërblim i kontratës sipas nën-paragrafit 5.2 paragrafi 5 të këtij neni do të nënshtrohet kërkesave për njohim të nenit 41 të këtij ligji, kërkesave për nënshkrim të nenit 26 të këtij ligji, dhe dhënia e secilës kontratë të tillë ndihmëse është subjekt i rregullave të cilat rregullojnë procedurën e shqyrtimit të ankesave të përcaktuara në Pjesën IX.
3. KRPP është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që të zhvillojë dhe shpallë rregullat dhe procedurat e nevojshme që qeverisin dhënien dhe përdorimin e kontratave publike kornizë. Rregullat dhe procedurat e tilla do të (i) promovojnë konkurrencë për kontrata të tilla, (ii) të sigurojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë e procesit, (iii) të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji mbi koston ekonomike, efikasitetin si dhe parimin e mos-diskriminimit të përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji; dhe (iv) të jetë në pajtim me praktikën e mira të vendeve anëtare të BE-së.

Pra kerkojm qe Ankesa jone te mirret si e bazur dhe te detyrohet Ak qe lenden ta kthej ne Rivlersim, pasi qe nuk jane ne Harmoni me Ligjet, Nenet dhe Rregulloren e KRPP-se per ta anulur nje procedur.

Ak duhet ta respektoj NENIN 7-te, të LPP_së i cili ne enyr te qartë thotë:

Neni 7 **Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që

diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.
6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Ne kete raste ne e ndjem vetem të prejashtur dhe Diskriminuar nga Ak-duke e anuluar proceduren as pa e marrur mundin q eta vlerosoj oferten, diqka qe automatikisht na len te pretendojm qe ne nuk jemi GOE e cila është dashur të ofertoj sipas preferencave te Ak-se (Zyrtareve te Prokurimit). Andaj duke u bazur ne te gjitha faktet tona dhe shkeljet e “Komisionit Vlersues”, duam të kerkojm te drejten tonë duke i respektuar dhe baur në ligjet e prokurimit Publikë të Kosovës, ashtu siq parashihen ne Rregulloren e cila e percakton kushtet dhe menyren e pjesmarrjes ne Procedur.

Andaj ne kërkojm nga OSHP që ti marr si të bazuara pretendimet tona dhe proceduara te ktheht ne Rivlerism dhe pas rivlersimit te mirret vendimi sipas Ligjeve te Prokurimit Publike te Kosoves.

AK duhet ta kete në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Ne si GOE kerkojm dokumentim te Aryses se cekur nga Ak, dhe kerkojm qe te marrim qasje ne Vlersimin e Ofertes nga Komisioni Vlersues.

Pra ne kemi kerkuar edhe qasje ne vlersimine

Ofertes dhe per ta pare qe me te vertet ka kerkuar Nje Drejtori apo eshte bere nje kerkes me shkrim paraprakisht nga Kompnai e projektimit qe ka patur mangesi ne paramas, por nuk e kemi marr, e kemi pranuar vetem nje leter te dyshimt e cila nuk e deshmon vertetesin e saj, pasi qe per ta dergur Drejtoria e Kultures Sportit dhe Rinis nje Email te till, ata paraprakisht është dashur ta pranojn dhe nje email nga Kompani Projektuese, apo e kunderta.

Pra, AK ka harruar parimin e proporcionalitetit, dhe ka marrë masë më të rëndë se sa e kërkon situata.

Nga ajo që u tha më lartë na shton bindjen se AK qëllimisht ka refuzar oferten tone dhe njëkohësisht ka veperuar dhe duke mos marr si te bazuara pretendimet tona ankimore, me te vetim qëllim lloshjen tone duke pretenduar heqje dore nga ankesa dhe përmbushje e apetivete per zyrtaret e AK-se.

Andaj, për të gjitha arsyet dhe faktet e parashtruara ne këtë Ankese, që pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore, provave dhe rrethanave te përcaktuara me sipër, me mirësjellje kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit të marrë këtë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar në tërësi ankesa e dorëzuar nga OE :**N&B SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit: NDERTIMI I KOMPLEKSIT TË BAZENIT OLIMPIK NËLEPOSAVIQ – FAZA 1 nr 641-25-8093-5-1-1 inicuar nga KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për Anulim te Procedures, dhe lënda kthehet në **Ri-Vlerësim;**

DETYROHET: AK, ri-vlerësimin, ekzaminimi, dhe krahasimi e ofertave të bëjë në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së, e mëpastaj për kontratë te rekomandohet GOE e vetme qe eshte ne Procedur si oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

**Natyrishhtë si një GOE që merret vetëm me këtë veprimtari ne në këtë procedurë jemi të dëmtuar materialishtë, financiarishtë dhe moralishtë, sepse jemi në mesin e OE të cilët merren vetëm me këtë veprimtari dhe diskriminimi që na është bërë na dëmton shumë dhe vlerat e dëmëve për ne janë mjaft të mëdha.
Nese e llogaritim koson financiare vetem për pregaditjen e ofertes kosto e kesaj e kalon mbi 10.000,00 Euro**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*